

## Mësimi 2: Këshillimi së Bashku

*Ju mund ta zhvillonit të gjithë mësimin ose ta ndani atë në segmente më të shkurtra. Përshatëni mësimin me rrethanat tuaja vendore dhe nevojat, moshën dhe kuptueshmërinë e presidencës të kuorumit ose klasës suaj.*

### KËSHILLIMI SË BASHKU SJELL FUQI

Mënyra e Zotit për ta udhëhequr Kishën e Tij është nëpërmjet këshillave (shih [Doktrina e Besëlidhje 43:8–10](#)). Këshillimi së bashku mund të na ndihmojë të jemi të bashkuar si presidencë kuorumi apo klase, të udhëhiqemi nga Shpirti në vendimmarrje dhe të jemi më të efektshëm në bërjen e punës së Zotit. Si mund të na ndihmojë këshillimi së bashku për të marrë vendime më të mira?

### KËSHILLIMI SË BASHKU MUND TË NA NDIHMOJË TË MARRIM ZBULESË

Plaku Nil L. Andersen dha mësim se “zbulësia është e shpërndarë midis nesh” (në [“Auxiliary Panels Use New Training Library”](#), *Ensign*, prill 2011, f. 76). Këshillimi na lejon ta mbledhim atë zbulësia ndërsa e planifikojmë dhe e kryejmë punën e Zotit. Për ta ilustruar këtë ide, ju mund t’i jepni çdo anëtar të presidencës disa pjesë të një figure formuese dhe ftojini të punojnë së bashku për ta plotësuar figurëformuesen.

- Si zbatohet ky shembull te këshillimi si presidencë?
- Përse është me rëndësi që secili të japë ndihmesë në një këshill?
- Çfarë mund të bëjmë për ta ndihmuar secilin të ndihet mirë duke marrë pjesë?
- Çfarë mund të bëjmë për ta ftuar dhe për ta dëgjuar Frymën e Shenjtë teksa këshillohemi së bashku?

Mendonit rreth një sfide apo nevoje në kuorumin apo klasën tuaj. Praktikoni këshillimin së bashku për mënyrën se si ta trajtoni atë.

### BURIME MBËSHTETËSE

- [Mateu 18:20](#)
- [Ethëri 2:14–3:16](#)
- [Doktrina e Besëlidhje 88:122](#)
- [Doktrina e Besëlidhje 107:84–87](#)
- M. Russell Ballard, *“Strength in Counsel”*, *Ensign*, nëntor 1993, f. 76–78
- *Manuali i Përgjithshëm: Shërbimi në Kishën e Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme*, 10.4, 11.3.4, [ChurchofJesusChrist.org](#)